



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 421/4 prot.

Tiranë, më 2.6.2025

V E N D I M

Nr.26, datë 2.6.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, SË
VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT TË ECURISË
DISIPLINORE, NË INSTITUCIONIN E ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË
BASENIT UJOR VJOSË, NË PËRBËRJE TË AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË
BURIMEVE UJORE, NË VARËSI TË KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses Pudrila Haskoçelaj, në Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, në përbërje të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe në varësi të Kryeministrisë,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni i dërguar me shkresën me nr. 421 prot., datë 1.4.2025, nga nëpunësja Pudrila Haskoçelaj, me detyrë “Specialiste e Informacionit dhe Inventarizimit të Burimeve Ujore”, në Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në të cilin ngrihen pretendimet për parregullsi të lejuara gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, në ngarkim të saj.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësja parashtroi se, me aktin nr. 114 prot., datë 25.3.2025, të titullarit

të institucionit, është vendosur dhënia e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, për nëpunësen Pudrila Haskoçelaj, me motivacion: “*Sjellje jo e rregullt me kolegët, si edhe shkelje e urdhrit të titullarit*”.

Në informacionin e dërguar, nëpunësja parashtroi se, motivacioni për fillimin e ecurisë disiplinore nuk qëndron, pasi pretendimet për shkelje të disiplinës në shërbimin civil, janë të pabazuara dhe të pajustificuara, e për pasojë masa disiplinore e dhënë në ngarkim të saj, është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga ligji në pjesën që rregullon institutin e disiplinës në shërbimin civil.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e eprorit direkt, gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil..

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me këtë informacion, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka filluar procesin e verifikimit të tij, nëpërmjet shkresës nr. 421/1 prot., datë 11.4.2025 “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja Pudrila Haskoçelaj, për dhënie mase disiplinore “Vërejtje”*”, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, si dhe duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, nëpërmjet shkresës nr. 421/2 prot., datë 22.4.2025 “*Kthim përgjigje*”, ka dërguar dokumentacionin në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar rezulton se, nëpunësja Pudrila Haskoçelaj është emëruar në pozicionin e punës “*Specialiste e Informacionit dhe Inventarizimit të Burimeve Ujore*”, në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, me aktin nr. 5440/2, datë 1.11.2023, të njësisë përgjegjëse DAP.

Rezulton se, në datën 25.3.2025, në kuadër të veprimtarisë së institucionit, nga ana e titullarit është zhvilluar një mbledhje me punonjësit e sektorit të informacionit, ku bën pjesë edhe nëpunësja P. Haskoçelaj, për të diskutuar zbatimin e detyrave të këtij sektori dhe për dokumentimin e mbledhjes, është mbajtur edhe procesverbali përkatës, me të njëjtën datë.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes, nga ana e titullarit të institucionit, që është njëkohësisht edhe eprori i drejtpërdrejtë i nëpunëses, kësaj të fundit i është vënë në dukje se vazhdimisht puna e kryer nga ajo, nuk ka qënë në nivelin e kërkuar, fakt ky i evidentuar në e-mailet dhe komunikimet që ka patur eprori me nëpunësen.

Në vijim të mbledhjes, për shkak të sjelljes së papërshtatshme të nëpunëses, eprori ka kërkuar që nëpunësja të largohet nga mbledhja. Kërkesë e cila është kundërshtuar nga nëpunësja, e për këtë arsye ai ka vendosur të ndërpresë mbledhjen.

Nisur nga sa më sipër, titullari i institucionit në cilësinë e eprorit të drejtpërdrejtë (*parashikuar në nenin 4, pika iv, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*), si dhe në mbështetje të pikës 1, të nenit 57, të këtij ligji, nëpërmjet postës elektronike (e-mail) të datës 25.3.2025, drejtuar nëpunëses Pudrila Haskoçelaj, ka njoftuar nëpunësen se në veprimet e kryera prej saj ka konstatuar mungesë të etikës dhe respektit ndaj eprorit, si dhe kolegëve. Kjo sjellje, referuar nenit 57, pika 4, germa b, të kreut X, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, si dhe Kodit të Etikës së AMBU, është klasifikuar prej tij në kategorinë: shkelje të lehta të disiplinës në shërbimin civil.

Në vijim, nëpërmjet e-mail-it të datës 25.3.2025, drejtuar eprorit të saj, nëpunësja ka parashtuar se, nuk është dakord me pretendimet e ngritura prej tij, duke i cilësuar ato si të pabazuara dhe të paarsyetuara. Më tej, eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet aktit nr. 114 prot., datë 25.3.2025, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, për nëpunësen Pudrila Haskoçelaj, me motivacionin: “Shkelja e rregullave të etikës”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se, nga ana e Drejtorit të Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe të kreut II, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, i ndryshuar, për sa i përket procedurës që duhej të ndiqej nga ky i fundit, në rastin e dhënies së masës disiplinore.

Sa i takon procedurës që duhet të ndiqet nga ana e organeve disiplinore, në rastin konkret, nga ana e eprorit të drejtpërdrejtë, pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, i ndryshuar, parashikojnë të gjitha hapat e kërkuar për nisjen e ecurisë disiplinore nga eprori, kur shkelja disiplinore konsiderohet e lehtë: njoftimin me shkrim të nëpunësit, duke e njohur me faktin e pretenduar si shkelje disiplinore; faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij; si dhe duke i dhënë mundësi nëpunësit të mbrohet, të paraqesë prapësimet dhe prova për të provuar se nuk ka kryer ndonjë shkelje disiplinore me faj.

Vetëm në përfundim të këtij procesi, eprori i drejtpërdrejtë në mbështetje të të gjithë akteve të administruara gjatë procedurës së hetimit disiplinor, duhet të marrë një vendim të argumentuar, të mbështetur në prova, nëse nëpunësi e ka kryer ose jo shkeljen dhe në rastet kur ekziston elementi i fajësisë për shkeljen e kryer, jepet masa disiplinore.

Kjo procedurë që duhet të ndiqet gjatë ecurisë disiplinore, e cituar në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, në mënyrë edhe me të detajuar për secilën fazë të saj parashikohet në Udhëzimin nr. 1, datë 21.1.2025, të Departamentit të Administratës Publike, të cilit organi i disiplinës duhet ti referohet.

Konkretisht, në mbështetje të pikës 9.1, të Udhëzimit të përmendur më sipër, pas verifikimeve të kryera nga eprori i drejtëpërdrejtë (*pika 8.1, e udhëzimit*), nëse shkelja e pretenduar klasifikohet si: “*shkelje e lehtë disiplinore*”, ky i fundit, vendos fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të nëpunësit, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen. Në vijim, sipas parashikimit të pikës 10, të këtij udhëzimi, me marrjen e vendimit të ndërmjetëm për fillimin e ecurisë disiplinore, eprori i drejtëpërdrejtë duhet të njoftojë menjëherë nëpunësin civil, duke respektuar afatin jo më vonë se 2 ditë punë, nga marrja e vendimit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij.

Në mbështetje të dokumentacionit të dërguar nga institucioni, në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast, sa i takon aspektit procedural të ecurisë, konstatohet se, nuk janë respektuar kërkesat ligjore të evidentuara më sipër, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument shkresor që të pasqyrojë veprimet administrative të kryera, gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunëses, prej eprorit të drejtëpërdrejtë, që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vlerësimit të shkeljes së pretenduar, marrjes së vendimit të ndërmjetëm, vënies në dijeni me shkrim të nëpunëses, seancën dëgjimore, e deri në marrjen e vendimit përfundimtar për masën disiplinore, “*Vërejtje me shkrim*”, të dhënë ndaj saj.

Për më tepër, konstatohet edhe përdorimi i një terminologjie që nuk është e parashikuar në ligjin për nëpunësin civil, në lidhje me llojin e masës disiplinore, që në këtë rast në aktin objekt shqyrtimi është evidentuar nga eprori i drejtëpërdrejtë si “*vërejtje me shkrim*”. Në këtë legjislacion, në rastin e shkeljeve disiplinore të klasifikuara si të lehta, aplikohet masa disiplinore “*Vërejtje*”, sipas nenit 58, gërma “a”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në këtë rast, rezulton se i gjithë procesi është finalizuar me aktin nr. 114 prot., datë 25.3.2025, të drejtuesit të zyrës, i cili ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, ndaj nëpunëses Pudrila Haskoçelaj.

Në këto rrethana, konstatohet se, akti nr. 114 prot., datë 25.3.2025, për dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, në ngarkim të nëpunëses Pudrila Haskoçelaj, është nënshkruar nga drejtuesi i zyrës, në rolin e eprorit direkt, duke mos respektuar anën procedurale për të nxjerrë një akt të tillë, si rrjedhim ky akt, në zbatim të gërmas a), ii), të nenit 108, “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm*”, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë. Më tej, referuar nenit 110 dhe nenit 111, të këtij ligji, ku parashikohet se, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, vetë organi publik, që në këtë rast përkon me Drejtorin e Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 114 prot., datë 25.3.2025, për dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, ndaj nëpunëses Pudrila Haskoçelaj, si dhe të rregullojë pasojat duke hequr aktin e dhënies së masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses, e njëkohësisht edhe nga Regjistri Qendror i Personelit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; germës a), ii), të nenit 108, 110 dhe nenit 111, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Drejtori i Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, në zbatim të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 114 prot., datë 25.03.2025, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, në ngarkim të nëpunëses Pudrila Haskoçelaj.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për kryerjen e veprimeve të mësipërme.
3. Të njoftohet për këtë vendim Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Departamenti i Administratës Publike si dhe nëpunësja Pudrila Haskoçelaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha